



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

In cooperation with:



Shkathësitë e buta



Emri i modulit të trajnimit: Shkathësitë e buta

Grup autorësh:

Ermira Berisha, Flandra Sadiku, Lejla Emrullahu, Vesa Hoxha.

Autore të dizajnit:

Flandra Sadiku, Lirije Zogaj.

KCDF ruan të drejtën të përdorë të gjitha fotografitë që ky modul i përmban.

© Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës, Prishtinë, Tetor 2020

© **GIZ CDBE** Ky material është zhvilluar me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Përmbajtja

Hyrje	4
1 Të kuptuarit e shkathtësive të buta	5
1.1. Dallimi në mes të <i>aftësive</i> dhe <i>shkathtësive</i>	5
1.2. Dallimi në mes të shkathtësive të buta dhe të forta	6
Pyetje përsëritëse	8
Mbani mend	8
2 Shkathtësitë e buta më të rëndësishme	9
2.1. Komunikimi	9
2.2. Të menduarit kritik	11
2.3. Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve	13
2.4. Puna në ekip	16
2.5. Shkathtësitë e hulumtimit	18
2.6. Etika e punës.....	19
2.7. Lidërshipi	20
2.8. Menaxhimi i kohës.....	22
2.9. Negocimi	23
2.10. Shkathtësitë nderpersonale	24
Pyetje përsëritëse	26
Mbani mend	26
3 Shkathtësitë e buta në jetë, shkollë dhe punë	27
3.1. Shkathtësitë e buta në jetë.....	27
3.2. Shkathtësitë e buta në mjedis shkolle	27
3.3. Shkathtësitë e buta në mjedis pune	28
3.4. Rëndësia dhe demonstrimi i shkathtësive të buta	28
Pyetje përsëritëse	29
Mbani mend	29
4 A janë të mësueshme shkathtësitë e buta?	30
4.1. Si t'i përmirësojmë shkathtësitë e buta?.....	30
4.2. Vlerësimi i shkathtësive të buta	30
Pyetje përsëritëse	31
Mbani mend	31
5 Përmbledhje	32
Referencat	33

Hyrje

Ky modul është zhvilluar nga organizata KCDF me mbështetje të GIZ CDBE për 20 Shkollat Kampione në të cilat janë ngritur Klubet e Karrierës.

Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës (Kosovo Career Development Foundation – KCDF) promovon dhe mbështet aktivitetet e ndërlidhura me orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë. Klubi i Karrierës është organizatë brenda shkollës që drejtohet nga nxënësit dhe përfshin aktivitete të cilat në mënyrë direkte apo indirekte ndërlidhen me planprogramet mësimore. Klubet përbëhen nga 15 nxënës të klasave VII, VIII dhe IX, të cilët kanë rolin e sekretariatit të Klubit, dhe mbështeten nga një mësime dhënë mbikëqyrës dhe menaxhmenti i shkollës. Ky modul është zhvilluar për t'i mbështetur nxënësit pjesëmarrës në aktivitetet e Klubeve të Karrierës që ta kuptojnë rëndësinë, t'i zhvillojnë dhe t'i demonstrojnë shkathtësitë e buta, siç janë:

- Komunikimi
- Mendimi kritik
- Zgjidhja e problemeve
- Puna në ekip
- Hulumtimi
- Etika në punë
- Lidhshipi
- Menaxhimi i kohës
- Negocimi
- Shkathtësitë nderpersonale

Përmes të njëjtit modul, nxënësit do të kenë mundësinë të mësojnë se çka janë shkathtësitë e buta, pse nevojiten ato, si mund t'i mësojmë ato, dallimin në mes shkathtësive të buta dhe të forta, disa nga llojet më të rëndësishme të shkathtësive të buta dhe raste nga jeta e përditshme ku përdoren këto shkathtësi.

Moduli përdor edhe shembuj praktik dhe profesione të shumta në të cilat lloje të caktuara të shkathtësive të buta janë esenciale, për t'iu ndihmuar nxënësve që në mënyrë praktike ta kuptojnë rëndësinë e tyre.

1 Të kuptuarit e shkathtësive të buta

Shkathtësitë e buta janë attribute personale që na mundësojnë të punojmë, performojmë e bashkëpunojmë me të tjerët në mënyrë që të arrijmë të funksionojmë suksesshëm në shoqëri. Ato janë pjesë e jetës së përditshme të secilit prej nesh.

Termi *shkathtësi të buta* shpeshherë mund të gjendet edhe si sinonim i fjalëve si: shkathtësi nderpersonale, shkathtësi thelbësore, shkathtësi praktike, shkathtësi njerëzore, etj. Shkathtësitë e buta shpeshherë konsiderohen të jenë pjesë e ndërthurur e personalitetit tonë dhe plotësojnë shkathtësi të tjera si ato të forta, akademike dhe profesionale.

Gjatë viteve të kaluara, për të fituar një vend të punës ka qenë e rëndësishme që t'i kemi të zhvilluara shkathtësitë e forta dhe të posedojmë kualifikimet e nevojshme për një punë të caktuar. Në shekullin aktual, për të pasur sa më shumë sukses në karrierë, përvetësimi i shkathtësive të buta është i domosdoshëm. Se sa të rëndësishme janë shkathtësitë e buta mund të vërehet lehtësisht nëse shikojmë cilëndo CV, ne do të vërejmë që secila prej tyre medoemos do të përfshijë edhe seksionin e shkathtësive, në të cilin zakonisht pëfshihen edhe shkathtësitë e buta dhe të forta.

Mirëpo, viteve të fundit mund të vërejmë që pjesa më e madhe e seksionit është e mbushur me shkathtësi të buta, të tilla si: komunikimi, puna ekipore, menaxhimi i kohës, mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve. Edhe gjatë intervistave, pyetjet që bëhen kanë për qëllim të vërtetojnë nëse me të vërtetë i posedoni këto shkathtësi. Të themi që në CV ju keni deklaruar që keni shkathtësi të mira të zgjidhjes së problemeve, atëherë intervistuesi mund t'iu kërkojë që të tregoni për një rast kur ju keni zgjidhur ndonjë problem dhe mënyrën se si e keni arritur atë.

Për ta kuptuar rëndësinë e shkathtësive të buta nuk kemi nevojë të presim deri në kohën e punësimit, kjo mund të vërehet lehtësisht që në moshë të hershme. Që nga koha kur fillojmë shkollimin parafillor e pastaj atë fillor, aktivitetet ditore dhe bashkëveprimi me të tjerët rritet në masë të madhe. Këtu pastaj vërehet një nevojë e shtuar e shkathtësive të buta për ta pasur sa më të lehtë këtë ndryshim të rëndësishëm jetësor. Ne duhet të komunikojmë me mësuesit / arsimtarët dhe shokët / shoqet e shkollës, duhet të mësojmë të lexojmë dhe të shkruajmë, të zgjidhim probleme të ndryshme që hasim në ambiente shkollore, etj. Të gjitha këto duhet t'i bëjmë tanimë në mënyrë të pavarur. Për t'i arritur të gjitha këto, shkathtësitë e buta që ne posedojmë do të na e lehtësojnë këtë proces.

1.1. Dallimi në mes të aftësive dhe shkathtësive


Shkathtësitë e buta shpeshherë nëpër literaturë mund t'i hasim edhe me termin *aftësi të buta*. Mirëpo, termi më i përshtatshëm është termi *shkathtësi të buta*. Aftësitë i referohen më shumë mundësisë që dikush ka për të nxënë / mësuar diçka të re. Ndërkaq, shkathtësitë e buta në shumë raste nuk konsiderohen si diçka e mësueshme, por diçka e cila është brenda nesh dhe zhvillohet në të njëjtën kohë me ne. Për ta pasur më të qartë, të marrim një shembull: aftësi mund të jetë përdorimi i kompjuterit, edhe nëse nuk dimë ta përdorim atë, mund ta mësojmë se si përdoret duke vijuar një trajnim, lexuar një manual për përdorim të kompjuterit, etj. Ndërkaq një shkathtësi mund të jetë komunikimi.

Dikush prej mund të ketë hasur në persona të cilët kanë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit dhe programeve të tij, por nuk arrijnë që këtë dije t'ua transmetojnë të tjerëve. Personave të tillë mund të themi që iu mungon shkathtësia e komunikimit (komunikimi oral për të qenë më specifik). Pra përkundër aftësive të shkëlqyera që ai /ajo ka në përdorim e kompjuterit, në mungesë të shkathtësive të komunikimit nuk arrin që atë që posedon ta transmetoj në atë mënyrë

që edhe të tjerët të përfitojnë. Gjithashtu, përvetësimi i shkathtësive të buta nuk është aq i drejtpërdrejt sikurse për aftësitë. Për shembull, nuk mund të bëhesh komunikues i mirë vetëm pas një trajnimi apo pasi të keni lexuar një manual rreth komunikimit, zhvillimi i shkathtësive të tilla kërkon kohë dhe praktikë në situata reale në jetën e përditshme. Prandaj, është e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm se cilat shkathtësi të buta kemi më tepër nevojë t'i zhvillojmë dhe rëndësinë e tyre, ashtu që ta ballafaqojmë vetën me situata të cilat krijojnë mundësi për përvetësimin e tyre.

1.2. Dallimi në mes të shkathtësive të buta dhe të forta

Shkathtësitë e forta iu referohen më shumë shkathtësive të cilat lidhen me njohuritë që fitohen përgjatë përvojave akademike dhe profesionale. Ato fitohen më së shumti përmes edukimit, trajnimeve, kurseve të ndryshme apo gjatë praktikimit të detyrave në vendin e punës. Këto shkathtësi janë të mësueshme dhe lehtë të matshme. Ndërkaq, shkathtësitë e buta konsiderohen më shumë si karakteristika të veçanta apo tipare të personalitetit, të cilat janë konsideruar si të pamësueshme. Por ato megjithatë mësohen. Se si mësohen shkathtësitë e buta do të diskutojmë më vonë në këtë modul.



Çdo punë kërkon disa lloje specifike të shkathtësive të forta, si për shembull:


- » Nëse punojmë si programerë, duhet të dimë gjuhë të ndryshme programuese.
- » Nëse jemi ligjëruese të gjuhëve të huaja, duhet të dimë gjuhët përkatëse rrjedhshëm.
- » Nëse punojmë si psikolog klinik, duhet të jemi të licencuar për këtë profesion.
- » Nëse dëshirojmë të punojmë si kuzhinier, duhet ta kemi të përfunduar shkollën e gastronomisë, etj.

Mirëpo për secilën nga këto profesione, që të jemi të suksesshëm duhet t'i posedojmë disa shkathtësi të buta, për shembull:

- » Për të qenë programerë të suksesshëm duhet të kemi edhe shkathtësi të mira në zgjidhje të problemeve.
- » Për të qenë ligjërues të suksesshëm të gjuhëve të huaja duhet të kemi shkathtësi komunikimi në mënyrë që të arrijmë të përçojmë tek të tjerët njohuritë tona.
- » Për të qenë psikolog klinik të suksesshëm duhet të jemi empatik. Pra, të jemi në gjendje t'i kuptojmë ndjenjat e të tjerëve dhe të bashkëndejmë me ta.

- » Për të qenë kuzhinier të suksesshëm duhet të kemi shkathtësinë e punës nën presion apo edhe menaxhimin të kohës.

Tabela e mëposhtme liston disa shkathtësi të forta dhe të buta për t'iu dhënë një pamje më të qartë se çka përfshihet në këto dy grupe të shkathtësive:



Shkathtësitë e forta

- Gjuhët programuese
- Njohje gjuhësh të huaja
- Njohuri përdorimi i paketës së Microsoft Office
- Shkathtësi menaxheriale
- Shkathtësi në shkrim
- Shkathtësi në dizajn
- Shkathtësi në instalim të ujit
- Shkathtësi matematikore
- Shkathtësi në kontabilitet
- Shkathtësi të shitjes



Shkathtësitë e buta

- Punë ekipore
- Kreativitet
- Fleksibilitet
- Shkathtësi në komunikim
- Shkathtësi të zgjidhjes së problemeve
- Shkathtësi lidershipi
- Dëgjimi aktiv
- Sinqeriteti
- Menaxhimi i kohës
- Etika e punës

Pyetje përsëritëse

- Çka janë shkathtësitë e buta?
- Përmendi disa sinonime të termit 'shkathtësi të buta'.
- Cili është dallimi në mes aftësive dhe shkathtësive? Ilustroni dallimin me një shembull tuajin.

Mbani mend

- Shkathtësitë e buta janë karakteristika personale të cilat na ndihmojnë të funksionojmë suksesshëm në shoqëri.
 - Rëndësia e shkathtësive të buta vërehet në masë të madhe me fillimin e shkollës, ku aktivitetet ditore dhe bashkëveprimi me të tjerët rritet.
 - Shkathtësitë e forta janë ato njohuri dhe aftësi të cilat fitohen përgjatë jetës. Iu referohen më shumë shkathtësive të cilat lidhen me njohuritë të cilat fitohen përgjatë jetës.
-



2 Shkathtësitë e buta më të rëndësishme

Ekzistojnë qindra shkathtësi të buta dhe që të gjitha janë të rëndësishme në aspekte të ndryshme jetësore. Për arsye që është e pamundur t'i shtjellojmë të gjitha në këtë modul, më poshtë do t'i përfshijmë disa nga më të përdorurat dhe më të domosdoshmet për t'u përvetësuar.

2.1. Komunikimi

Komunikimi është procesi i ndarjes dhe marrjes së informacionit në mënyrë efektive. Ne mund të themi që kemi pasur një komunikim efektiv kur në fund të bisedës ne kemi dhe jemi kuptuar nga të tjerët. Një komunikim efektiv rezulton në një funksionim të mirë në shoqëri dhe mundësi të larta suksesi në jetën personale, akademike dhe profesionale.

Të komunikosh me shokun / shoqen e klasës nuk është e njëjtë si të komunikosh me mësimdhënësin. Prandaj, mënyra se si sillemi dhe flasim para tyre është e ndryshme. Në momentin që ne e dimë se si të komunikojmë dhe të kuptohemi me të tjerët suksesshëm, do të thotë që shkathtësitë e komunikimit i kemi mirë të zhvilluara.

Pse janë të rëndësishme shkathtësitë e komunikimit?

Shkathtësitë e komunikimit janë jashtëzakonisht të rëndësishme për arsye se mënyra se si ne komunikojmë me të tjerët në masë të madhe përcakton edhe mënyrën se si të tjerët na shohin neve dhe sa sukses do të kemi në të ardhmen. Në momentin që ne kemi shkathtësi të mira komunikimi, kjo nënkupton që ne do të jemi në gjendje të japim dhe marrim informacionin në mënyrë të suksesshme dhe rrjedhimisht edhe suksesi në punë do të jetë i garantuar. Niveli i shkathtësive tona të komunikimit varet edhe nga niveli i vetëvlerësimit. Sa më të lartë që e kemi nivelin e vetëvlerësimit, aq më të zhvilluara do t'i kemi shkathtësitë e komunikimit.

Mënyrat e komunikimit që përdorim për të pasur komunikim efektiv

Komunikimi verbal

Ky është lloji më i dallueshëm dhe bazik i komunikimit. Komunikimi verbal përdorë fjalët e folura për të komunikuar me të tjerët. Ky lloj i komunikimit mund të ndodhë ballë-për-ballë apo edhe në distancë. Për shembull, një takim në zyrën e mësimdhënësit apo bisedë përmes telefonit, video konferencës, etj.

Komunikimi jo-verbal

Është e kundërta e komunikimit verbal. Ky komunikim përfshin komunikimin e shkruar si dhe mesazhet që transmetojmë përmes gjuhës së trupit dhe intonacionit. Gjatë kohës që ne themi diçka, mënyra dhe toni i zërit që e përdorim ka vlerë të madhe. Një fjali si: "Ku jeni duke shkuar?", mund të jetë thjeshtë një pyetje por mund të jetë edhe qortim që nënkupton se nuk është e lejuar të dalësh pa marrë leje. Këtë dallim e bën toni i zërit i cili përfshihet tek komunikimi jo-verbal. Edhe gjuha e trupit e tillë si shprehjet e fytyrës, pozicioni i trupit, pozicioni i duarve, kontakti me sy, që të gjitha këto përbëjnë komunikimin jo-verbal. Po ashtu, është e rëndësishme të kemi përputhje në mes komunikimit verbal dhe jo-verbal për arsye se shpërputhja e këtyre dy formave të komunikimit shkakton konfuzion tek pala tjetër. Kur ndodh kjo shpërputhje mund të shkaktoni dyshime tek ai / ajo që pranon informacionin, për shkak se pranuesi mund të jetë i hutuar se në cilën formë të transmetimit të informatës duhet të mbështetet. Për shembull, dhënia e një komplimenti pozitiv i cili përcillet me një shprehje të fytyrës të ngrysur lë të nënkuptojë që në fakt ai kompliment nuk është i sinqertë.


Dëgjimi

Është një ndër aspektet kryesore të komunikimit. Këtu nuk përfshihet dëgjimi si shqisë por përfshihet dëgjimi aktiv. Shpeshherë kur flasim me dikë, në mendje kemi mendimet tona, si pritshmëritë se çfarë do të thotë tjetri apo edhe mendime tjera që nuk kanë të bëjnë fare me situatën. Të dëgjuarit aktiv nënkupton vëmendje totale ndaj folësit. Shkathtësia për t'i kuptuar të tjerët përderisa flasin dhe të kuptuarit se si ata ndihen gjatë atij komunikimi, do të thotë që ju i bëni ata të ndihen të kuptuar, gjë e cila është shumë e rëndësishme për një marrëdhënie të shëndoshë nderpersonale.

Shkathtësitë e prezantimit

Përfshijnë të gjitha shkathtësitë e lartpërmendura, siç janë: komunikim verbal, jo verbal dhe dëgjimin. Shkathtësitë tona për të bërë prezantime të mira, i bën të tjerët të nënkuptojnë që shkathtësitë e përgjithshme të komunikimit i kemi të mira. Për shembull, në klasë gjatë prezantimeve grupore apo individuale, disa nga shokët / shoqet e klasës arrijmë t'i kuptojmë më lehtë sesa të tjerët. Kjo është rezultat i shkathtësive të tyre të prezantimit dhe mënyrës se si arrijnë ata të transmetojnë mesazhin kryesor, duke kombinuar mënyrat e ndryshme të komunikimit.

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Arbesa ishte në shtëpi duke punuar në disa raporte të punës kur në dhomë erdhi Erza, vajza e saj, e cila ishte e pikëlluar. Erza filloi të bisedoj me nënën e saj duke ia shprehur ndjenjat e saj dhe arsye se pse ishte e mërzitur. Arbesa duke e vazhduar punën e saj normalisht, vetëm i tha: “do të bëhet mirë zemër” mirëpo vajza vetëm sa vazhdoi dhe u pikëllua edhe më shumë. Në atë moment Arbesës iu kujtua se sa i rëndësishëm ishte komunikimi jo verbal. Kështu që, ajo i la për disa momente punët që kishte dhe u kthye nga vajza e saj, i dha një përqaqim të ngrohtë dhe me një zë qetësues i tha prapë që “çdo gjë do të bëhet më mirë”. Këtë herë vajza e saj pati një buzëqeshje të menjëhershme dhe ashtu e gëzuar u kthye për të vazhduar lojën.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojiten shkathtësitë e komunikimit

Ky seksion do të jetë në secilën shkathtësi të shpjeguar në vazhdim. Profesionet e përmendura në seksionet në vazhdim nuk janë profesionet e vetme që kërkojnë shkathtësitë e cekura, mirëpo janë profesione në të cilat ato shkathtësi kanë një rëndësi më të theksuar, dhe rrjedhimisht, nevoja për to është më e madhe sesa në profesionet tjera.

Duke pasur këtë në mendje, më poshtë janë të listuara disa profesione / pozita që mund të jenë të përshtatshme për ju nëse keni shkathtësi të mira komunikimi:



2.2. Të menduarit kritik

Të menduarit kritik na mundëson arritjen në një gjykim dhe zgjedhje të duhur. Kur ne mendojmë në mënyrë kritike, me kujdes analizojmë alternativat dhe i vlerësojmë ato duke i krahasuar me njëra-tjetrën për të arritur në një përfundim i cili do të jetë më i dobishmi i mundur për të zgjidhur një problem apo për të marrë një vendim. Ta kesh të zhvilluar këtë shkathtësi nuk do të thotë të mbash në mend shumë informata dhe fakte. Mirëpo, të përdorësh mendimin kritik nënkupton edhe hulumtimin në internet, përzgjedhjen e burimeve të informacionit duke kuptuar se cilat janë të besueshme, më pas t'i kombinosh edhe me njohuritë që i posedon dhe në fund të arrish në zgjidhjen më të mirë të mundshme.


Pse janë të rëndësishme shkathtësitë e mendimit kritik?

Shkathtësitë e mendimit kritik janë të rëndësishme sepse përmes të menduarit kritik ne bëjmë zgjedhjet tona të cilat na përcaktojnë edhe të ardhmen tonë. Duke filluar nga përzgjedhja e shkollës së mesme të lartë, fakultetit apo edhe profesionit, ne përdorim shkathtësitë e mendimit kritik për të marrë vendime, duke i analizuar përparësitë dhe mangësitë e secilës alternativë. Mirëpo, mendimi kritik nuk përfundon këtu, pasi që na ndihmon të reflektojmë për vetën dhe të kuptojmë ku të ndërhyjmë për të përmirësuar edhe kualitetin e jetës tonë.

Shkathtësi të tjera që përfshihen në shkathtësitë e mendimit kritik

Observimi / vështrimi	Është pjesë e rëndësishme e mendimit kritik sepse është pikënisja e tij. Me anë të observimit ne mund të identifikojmë një problem të ri apo edhe ta parashikojmë atë në bazë të përvojave tona.
Analiza	Pasi që identifikojmë problemin, ne duhet të fillojmë analizimin e tij duke identifikuar se çfarë është dhe mund të jetë relevante rreth atij problemi dhe çfarë jo.
Përfundimi	Pasi që bëhet mbledhja e informatave të nevojshme atëherë vazhdojmë me nxjerrjen e përfundimeve rreth atyre informatave që kemi marrë, gjë e cila na ndihmon në zgjidhjen e problemit.
Komunikimi	Edhe pse komunikimi është edhe shkathtësi në vete, ai por edhe shkathtësi të tjera mund të hyjnë edhe si nënkategori të një shkathtësie tjetër. Në këtë rast shkathtësia e komunikimit na mundëson të shpjegojmë suksesshëm gjithçka që kemi bërë për të arritur te zgjidhja, duke ju referuar 3 pikave më lartë.
Zgjidhja	Edhe kjo është një shkathtësi e nevojshme për mendimin kritik, sepse në fund të fundit i gjithë procesi i mendimit kritik ka për qëllim identifikimin e zgjidhjes së duhur për një temë / problem të parashtruar në fillim.

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Debatet mund të jenë burime të rëndësishme në të cilat mund t'i përdorim dhe zhvillojmë shkathtësitë e mendimit kritik. Në një debat gjithmonë ekzistojnë dy apo më shumë palë që kanë dallime në mendime rreth një apo më shumë çështjeve të caktuara. Nëse ne jemi pjesëmarrës aktiv në debat atëherë ne duhet të analizojmë mirë temën që do të debatohet si dhe të përgatisim argumente bindëse për anën të cilën do të mbajmë. Përkundër përgatitjes paraprake që mund të kemi, pala kundërshtuese mund të na jap argumente të cilat nuk i kemi pritur. Në këtë rast duhet të mendojmë shpejtë por edhe hollësisht rreth informacionit që kemi marrë dhe të mundohemi të japim përgjigjen më të arsyeshme. Edhe nëse jemi dëgjues pasiv të një debati, ne mund t'i dëgjojmë argumentet e secilës palë dhe pastaj kujdesshëm të analizojmë argumentet dhe debatin në përgjithësi, e më pas mund të vijmë edhe me një qëndrim tonin nëse nuk kemi pasur një qëndrim apo edhe të vendosim nëse qëndrimi që kemi pasur deri në atë moment është i duhuri apo jo.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojiten shkathtësitë e mendimit kritik

Nëse keni shkathtësi të mira të mendimit kritik, këto profesione mund të jenë të përshtatshme për ju:



2.3. Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve

Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve janë shkathtësi të cilat na ndihmojnë të zgjidhim probleme me të cilat përballemi gjatë jetës personale apo profesionale. Këtu përfshihen edhe problemet me të cilat jemi përballur në të kaluarën, por veçanërisht problemet e reja që kërkojnë zgjidhje të reja, të cilat nuk i kemi përdorur më parë. Të kesh shkathtësi të zgjidhjes së problemeve do të thotë të:

- » Jesh i/-e aftë të identifikosh problemin
- » Gjesh alternativa të mundshme për zgjidhje
- » Vlerësosh dhe përcaktosh alternativat më të mira
- » Zbatosh atë apo ato alternativa
- » Vlerësosh rezultatin e alternativës së zgjedhur.

Pse janë të rëndësishme shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve?

Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve janë shkathtësi të nevojshme në çdo fushë të jetës. Ato na mundësojnë të tejkalojmë vështirësitë dhe pengesat gjatë rrugës drejt një qëllimi të caktuar. Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve kërkohen sidomos në vend të punës, pasi që në çdo vend të punës do të ketë sfida dhe probleme të cilat kërkojnë zgjidhje. Nëse kemi këto shkathtësi është lehtë t'i shfaqim para punëdhënësit tonë, sepse ne zakonisht jemi të trajnuar për të bërë një punë, por kur shfaqen probleme të papritura atëherë kemi mundësi që t'i shfaqim këto shkathtësi duke na mundësuar të jemi të vlerësuar nga punëdhënësi. Tutje, kjo shkathtësi na e rrit edhe nivelin e vetëbesimit.

5 hapat e zgjidhjes së problemeve

Identifikimi i problemit	<p>Në hapin e parë duhet të bëhet identifikimi i problemit sa më qartë që është e mundur në mënyrë që të kemi mundësi zgjidhje. Pra, duhet të identifikojmë rrënjën e problemit dhe jo pasojat që ka sjellë ai problem.</p>
Përcaktimi i elementeve kryesore të problemit	<p>Ndarja e problemit në pjesë më të vogla na lehtëson menaxhimin e tij dhe procesin e krijimit të planit për zgjidhje të atij problemi.</p>
Shqyrtimi i zgjidhjeve të mundshme	<p>Pas identifikimit dhe ndarjes së problemit në pjesë më të menaxhueshme, atëherë e kemi më të lehtë edhe shqyrtimin e mundësive të zgjidhjes së elementeve të problemit, i cili pastaj rezulton në zgjidhjen totale të problemit. E rëndësishme është që të bëjmë një shqyrtim të detajuar të mundësive në mënyrë që në fund të zgjedhim mundësinë më të mirë për ta zgjidhur problemin me sukses. Pasi të kuptojmë se si do t'i qasemi problemit, bëjmë edhe një plan veprimi se si të zbatohet procesi i zgjidhjes së problemit.</p>
Zbatimi i planit të zgjedhjes së problemit	<p>Pasi që kemi ndarë problemin në pjesë më të vogla dhe kemi zgjedhur një mënyrë të caktuar të zgjidhjes së problemit, atëherë është koha që ta zbatojmë atë zgjedhje sipas planit të veprimit. Gjatë kësaj kohe është mirë të jemi në linjë me planifikimin që kemi bërë. Kjo mund të bëhet përmes monitorimit të vetvetes, nëse veprimet tona përputhen me planin paraprak.</p>
Vlerësimi i procesit dhe nxirrja e mësimeve	<p>Hapi i fundit përfshin vlerësimin e tërë procesit të zgjidhjes së problemit. Nëse kemi arritur ta zgjidhim problemin, atëherë mund të konsiderojmë që kemi qenë të suksesshëm. Megjithatë, pavarësisht nëse tregohemi të suksesshëm apo jo, ne mund të nxjerrim mësimë se çka ka shkuar mirë dhe çka jo. Nxjerrja e këtyre mësimeve na mundëson që herën tjetër kur të përballemi me një problem, ne të dimë se sa janë mundësitë që diçka të funksionojë apo jo.</p>

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Rrezja gjatë bërjes së detyrave në lëndën e matematikës has në një detyrë që është më ndryshe se ato që janë shpjeguar në klasë. Ajo vëren që në këtë detyrë janë dy të panjohura ndërkaq, në klasë janë ushtruar detyrat që kanë pasur vetëm një të panjohur (identifikon problemin). Ajo mendon se si mund të zgjidh këtë detyrë. Më pas ajo shikon rreth burimeve që mund të shfrytëzoj për të gjetur mënyrën e zgjidhjes së problemit. Ajo si alternativa ka konsultimin e librit për të parë nëse ka detyra të ngjashme që janë të zgjidhura, hulumtimin në internet për këtë lloj detyre, konsultimin me shokët / shoqet e klasës apo konsultimin edhe me ndonjë familjar që ka njohuri të mira në matematikë (identifikimi i alternativave). Më pas bën vlerësimin dhe përcaktimin e alternativave të cilat mund të jenë më të dobishme dhe efektive për të (vlerësimi dhe përcaktimi i alternativave). Pas që merr vendimin se kënd do ta konsultoj, ajo e bën atë dhe me informatat që merr e zgjidh detyrën e parashtruar (zbatimi i alternativës së përzgjedhur). Në fund ajo dorëzon detyrën tek arsimtari i lëndës dhe pret vlerësimin nëse detyra e zgjidhur është e saktë apo jo. Nëse detyra ka qenë e saktë atëherë do të thotë që ajo ka konsultuar alternativën e duhur, nëse detyra nuk është e saktë do të thotë që alternativa e përcaktuar është dashur të jetë tjetër (vlerësimi i zgjedhjes) dhe nga kjo Rrezja mëson zgjidhjen e duhur për detyrën në fjalë.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojiten shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve

- » Profesionet që përfshijnë hetime si:
 - investigator/-e privat/-e, prokuror/-e,
 - polic/-e, avokat/-e
- » Fizikant/-e
- » Kontrollues/-e i/e trafikut ajror
- » Anesteziolog/-e
- » Punëtor/-e social/-e
- » Matematikan/-e
- » Profesione në arsim si: mësues/-e, arsimtar/-e, profesor/-esh, drejtor/-esh shkolle, etj.

2.4. Puna në ekip

Puna në ekip është shkathtësia e një personi për të punuar suksesshëm me një grup të njerëzve drejt një qëllimi të vendosur. Shkathtësitë e punës në grup i përdorim që nga fëmijëria nëpër lojëra të ndryshme që kërkojnë bashkëpunim me shokët e shoqet e lagjes dhe kjo shkathtësi vazhdon të përdoret edhe në shkollë, si për shembull në projekte të ndryshme grupore apo edhe sporte kolektive (futboll, basketboll, volejboll, futboll amerikan, etj).



Pse janë të rëndësishme shkathtësitë e punës në grup?

Pasi që përgjatë jetës do të na duhet të kemi bashkëpunim me grupe të ndryshme njerëzish është e rëndësishme të dimë edhe si të sillemi dhe punojmë në mënyrë që ai bashkëpunim në fund të jetë i frytshëm. Personat të cilët nuk e kanë problem punën në grup zakonisht janë po ata persona të cilët do të jenë më të suksesshëm në jetën dhe karrierën e tyre. Shkathtësitë e punës në grup na hapin rrugët edhe për punë dhe mundësi të tjera të cilat na aftësojnë edhe më shumë. Po ashtu puna në grup nxit unitet dhe si rrjedhojë personat që e përbëjnë atë grup e motivojnë njëri-tjetrin për të punuar edhe më shumë si dhe bashkërisht t'i tejkalojnë vështirësitë që hasin gjatë rrugës.

Shkathtësi të tjera që përfshihen në shkathtësitë e punës në ekip

Komunikimi

Ashtu si pothuajse në çdo shkathtësi tjetër edhe këtu shkathtësitë e komunikimit janë të rëndësishme. Komunikimi i vazhdueshëm me të tjerët rreth progresit dhe detyrave të përfunduara dhe po ashtu detyrave të ardhshme që ka gjithsecili janë shumë të rëndësishme për suksesin e ekipit.

Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve

Njëjtë si në punë individuale edhe në punë ekipore, probleme të ndryshme do të shfaqen përgjatë punës, për këtë arsye zhvillimi i kësaj shkathtësie do të ndihmojë edhe në zhvillimin e shkathtësive të punës në grup.

Dëgjimi

Nëse dëshirojmë që të punojmë në grup atëherë është e rëndësishme që të dëgjojmë edhe arsimtarët apo shokët / shoqet e klasës dhe perspektivat e tyre. Ata mund t'iu qasen punës, detyrave dhe problemeve në mënyra që ndoshta ne nuk i kemi konsideruar

Bashkëpunimi

por mund të jenë mënyra të cilat janë shumë praktike e efektive për të gjithë grupin. Kështu, lehtësohet edhe mësimi i materialeve të reja mësimore.

Kjo është një shkathtësi që nuk do shumë shpjegim. Bashkëpunimi me të tjerët është i pashmangshëm nëse dëshirojmë të bëjmë punë ekipore. Këto dy koncepte shpeshherë përdoren si sinonime të njëra tjetrës prandaj në seksionin tjetër do të shpjegojmë se ku dallojnë këto dy koncepte.

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Besarti dhe katër shokët e tij kanë një projekt shkollor të përbashkët për lëndën e Biologjisë. Ata takohen një ditë pas shkolle dhe bashkërisht vendosin se cilat pjesë të projektit do të bëjnë secili prej tyre. Ata i ndajnë pjesët duke pasur parasysh preferencat dhe shkathtësitë e secilit. Ata po ashtu japin ide se si duhet të duket ky projekt dhe më pastaj përzgjedhin idetë më të mira dhe praktike për përfundimin e suksesshëm të projektit. Gjatë punës së tyre ata vazhdimisht informojnë njëri-tjetrin rreth progresit të bërë dhe po ashtu kur ndonjëri prej tyre has në ndonjë problem ata i ndihmojnë duke i dhënë ide se si mund të zgjidhet ai problem. Në fund me anë të bashkëpunimit dhe punës në grup ata arrijnë të përfundojnë projektin në mënyrë të shkëlqyeshme.

Disa nga profesionet / pozitat për të cilat nevojiten shkathtësitë e punës në grup

Kamerier/-e
Marketing dhe Komunikim
Punëtor/-e ndërtimtarie
Menaxher/-e i/-e burimeve njerëzore
Punëtor/-e magazine
Punëtor/-e fabrike
Përgjegjës/-e i/-e transportit dhe pranimit të mallrave

2.5. Shkathtësitë e hulumtimit

Shkathtësitë e hulumtimit na e mundësojnë të kërkojmë, gjejmë, analizojmë, interpretojmë dhe vlerësojmë informata duke u bazuar në temën për të cilën jemi duke hulumtuar.

Gjasat që ju keni përdorur shkathtësitë e hulumtimit janë të mëdha. Nëse keni kërkuar të themi rreth dëmeve që i shkaktojnë pijet e gazuara apo cilat prej tyre kanë më së shumti përmbajtje të sheqerit, atëherë ju keni përdorur shkathtësitë tuaja të hulumtimit. Në shkollë po ashtu kur keni për të shkruar ese për ndonjë temë të caktuar dhe keni kërkuar informata rreth temës në internet, libra apo gazeta është dëshmi që ju keni përdorur shkathtësitë e hulumtimit. Ndërkaq, gjatë shkollës së mesme e tutje, nevoja për të përdorur këto shkathtësi do të jetë gjithmonë në rritje.

Pse janë të rëndësishme shkathtësitë e hulumtimit?

Hulumtimi është një ndër veglat kryesore që mund të përdorim për të zgjeruar njohuritë tona për cilëndo temë. Zgjerimi i horizontit të njohurive dhe shkathtësive tona për të arritur deri tek informacioni i ri dhe i saktë është një aset shumë i fuqishëm i cili na jap mundësi të mëdha për rritje akademike, personale dhe profesionale. Është shumë e rëndësishme që në momentin që ne themi diçka të kemi edhe fakte dhe referenca të cilat e mbështesin atë që themi. Kjo na bënë ne më të besueshëm në atë që themi.

Shkathtësitë e hulumtimit në nivelin akademik mund të na i rrisin gjasat për vlerësim më të lartë nga ana e arsimtarit ndërkaq nga ana profesionale na i rrisin gjasat për një punë afatgjate me mundësi ngritje në pozitë përgjatë viteve sepse punëdhënësit e vlerësojnë lart këtë shkathtësi.

Shkathtësi të tjera që përfshihen në shkathtësitë e hulumtimit

Vëmendja ndaj detajeve

Është e rëndësishme që gjatë kohës së hulumtimit të jemi shumë të vëmendshëm në detajet e informacionit që marrim pasi që ato mund t'i japin krejt tjetër kuptim informacionit dhe po ashtu mund të na duhet edhe në të ardhmen për hulumtime të tjera që kanë ndërlidhje me hulumtimin e tanishëm.

Marrja e shënimeve

Shkathtësia që gjatë kohës që hulumtojmë të marrim shënim pjesët kryesore të artikullit apo faqeve të librit që jemi duke i lexuar janë shumë të rëndësishme për qasjen më të lehtë kur i rikthehemi atij informacioni.

Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve

Ne përveç që hulumtojmë për të marrë informacion të ri ne mund të hulumtojmë edhe për të zgjidhur probleme të ndryshme, për këtë arsye këto dy shkathtësi e përbushin dhe janë të rëndësishme për njëra-tjetrën.

Menaxhimi i kohës

Përgjatë hulumtimit në të shumtën e kohës ne përballemi me një afat kohor kur raporti për atë hulumtim duhet të jetë i gatshëm. Prandaj shkathtësitë e ndarjes së punës në segmente më të vogla, planifikimi ditor i punës, plani se si hulumtimi do të zhvillohet, kategorizimi i punëve në bazë të prioritetit, të gjitha këto përfshihen tek shkathtësitë e menaxhimit të kohës të cilat mundësojnë që hulumtimi të shkojë mbarë.

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Ari është në përfundim të klasës së IX-të dhe tani është koha që ai të vendos se në cilën shkollë të mesme do të vazhdoj. Ai ende nuk ka vendosur ku të regjistrohet në shkollë të mesme. Kështu, si fillim ai përqendrohet në hulumtim të një mjeti që do të ja lehtësoj procesin e tranzicionit të tij nga shkolla e mesme e ulët në shkollë të mesme të lartë. Duke hulumtuar në internet, ai gjen platformën Busulla.COM, ku kupton që mund të filloj njohjen e vetvetes përmes testit të personalitetit dhe pastaj vazhdon në eksplorimin e profesioneve të ndryshme dhe në fund identifikon shkollën e përshtatshme për profesionin e tij të preferuar. Ari ndjehet shumë i sigurt në zgjedhjen e tij për shkollë të mesme të lartë, pasi që zgjedhja e tij është bazuar në disa faktorë shumë të rëndësishëm që do të përcaktojnë suksesin e tij në karrierën e tij të ardhshme.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojiten shkathtësitë e hulumtimit

- » Historian/-e
- » Antropolog/-e
- » Arkeolog/-e
- » Sociolog/-e
- » Psikolog/-e hulumtues/-e
- » Hulumtues/-e kualitative dhe/-apo kuantitative
- » Hulumtues/-e tregu
- » Hulumtues/-e mjekësor/-e
- » Agronom/-e

2.6. Etika e punës

Etika e punës është një grup i vlerave morale të cilat e ndihmojnë një person që të përfundoj punët e tij/-saj, të tregoj respekt për kolegët e punës, për orarin (saktësinë në orar) dhe është i përgjegjshëm për detyrat e tij/-saj, pra nuk është e domosdoshme që menaxheri i tij/-saj të ia rikujtoj vazhdimisht përgjegjësitë që i ka ndaj punës që bën.

Pse është e rëndësishme etika e punës?

Shkathtësia e etikës së punës ka rëndësi të madhe veçanërisht në ambiente pune. Menaxherët gjatë rekrutimit të stafit të ri preferojnë kandidatë të cilët e posedojnë këtë shkathtësi sepse iu mundëson atyre të kenë afër vetës persona me integritet dhe të cilët e trajtojnë punën me përgjegjësi. Etika e punës bëhet pjesë e asaj se kush ne jemi dhe rrjedhimisht është e rëndësishme në definimin e personalitetit tonë. Nëse kemi një etikë të fortë të punës do të jemi persona të cilët do të shihen pozitivisht në ambiente pune dhe na i rrit mundësitë për ngritje në pozitë.

Shkathtësi të tjera që përfshihen në shkathtësitë e etikës së punës

Profesionalizmi


Mënyra se si ne flasim, sillemi dhe vishemi na shfaq ne si profesional apo e kundërta. Për të pasur etikën e punës si shkathtësinë tënde të fortë, atëherë është e domosdoshme që të kemi edhe një sjellje dhe dukje profesionale.

Produktiviteti

Një ndër mënyrat më të mira për të treguar që i posedojmë shkathtësitë e etikës në punë është të tregojmë produktivitet të lartë në punë.

Devotshmëria/Përkushtimi

Fokusimi i plotë në detyrat afatgjate dhe afatshkurta të punës dhe përkushtimi për të punuar deri sa të përfundojnë detyrat e



tyre përfshihet tek devotshmëria në punë, e cila më pas është pjesë përbërëse e etikës së punës.

Personat të cilët kanë etikë të punës atëherë ata edhe tregojnë disiplinë të madhe në punën e bërë. Ata përpiqen për të arritur apo edhe tejkaluar pritjet dhe janë të motivuar për të mësuar çdo ditë diçka të re për të përmirësuar vetën.

Duke bashkëpunuar me të tjerët ne mund ta ndajmë etikën e punës me të tjerët duke iu ndihmuar edhe atyre të ushtrorjve atë. Puna me zell në projekte dhe detyra të punës i motivon edhe kolegët që të bëjnë të njëjtën gjë.

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Mali ka një vit që është duke punuar në një kompani. Menaxherët e tij janë duke e menduar seriozisht promovimin e tij në punë për arsye të shumta. Që nga fillimi i punës Mali ka treguar një përkushtim të madh për punën, ka dhënë gjithmonë 101% nga vetja, ka marrë përgjegjësi për vendimet e marra, ka respektuar rregullat e kompanisë dhe në çdo moment është treguar tejet profesional. Për këtë arsye ata kanë rënë dakord që Mali ka treguar kualitetet e duhura për të vazhduar në pozita më të larta në kompani.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojiten shkathtësitë e etikës së punës

Këtu nuk do të listojmë asnjë profesion pasi që nuk mundemi të klasifikojmë se cili profesion e ka më të rëndësishme se tjetra këtë shkathtësi sepse është shkathtësi e domosdoshme për secilin person dhe rrjedhimisht e cilitdo profesionist.

2.7. Lidershipi

“Liderët e vërtetë e dinë se udhëheqja nuk ka të bëjë me ta por për ata të cilët i shërbejnë. Nuk bëhet fjalë për ngritjen e vetvetes por për ngritjen e të tjerëve.”

- Sheri L. Dew, autore amerikane

Shkathtësitë e lidershit përdoren atëherë kur ne duam të udhëheqim me persona, grupe apo edhe organizata / kompani të ndryshme. Të jesh një lider do të thotë që ju të udhëhiqni me ekipin tuaj drejt qëllimeve të caktuara, duke ndikuar pozitivisht dhe duke e motivuar ekipin. Për ta bërë këtë ju duhet të keni disa shkathtësi të cilat kur kombinohen me njëra-tjetrën formojnë një lider të suksesshëm.

Pse është e rëndësishme shkathtësia e lidershit?

Kjo shkathtësi është e rëndësishme në veçanti për ata persona të cilët kanë për qëllim që në karrierën e tyre të jenë në pozita menaxhuese ku duhet të menaxhojnë një grup të personave apo edhe të gjithë kompaninë apo organizatën. Personat që e kanë këtë shkathtësi janë të rëndësishëm për bizneset dhe organizatat, sepse ndikojnë në suksesin e përgjithshëm të tyre. Shkathtësitë e lidershit mund të jenë të rëndësishme edhe jashtë karrierës profesionale, pasi që ka raste të ndryshme ku ne duhet të marrim përgjegjësi në familje apo shoqëri për të udhëhequr ndonjë punë.

Disa nga shkathtësitë kryesore të një lideri

Komunikimi	<p>Për të qenë një lider i mirë është e domosdoshme të kemi shkathtësi të mira të komunikimit. Shkathtësitë e komunikimit na duhen sepse ne duhet të jemi shumë të qartë në atë çka themi, sepse nga ajo varet shumë edhe suksesi i gjithë ekipit. Mirëpo mos të harrojmë edhe të dëgjuarit sepse si lider ne duhet të formojmë një lidhje të shëndetshme në mes liderit dhe ekipit për të siguruar një harmoni ekipore.</p>
Delegimi	<p>Nuk mund të jesh një lider i suksesshëm nëse mundoheni t'i bëni të gjitha punët vet. Kjo është e rëndësishme për ta kuptuar sepse shumë persona e konsiderojnë ndarjen / delegimin e detyrave tek të tjerët si shenjë dobësie, por që në fakt është krejt e kundërta.</p>
Përgjegjësia	<p>Është e rëndësishme që si një lider të jesh i gatshëm të marrësh përgjegjësi jo vetëm për sukseset por edhe dështimet e ekipit. Nëse ju e merrni tërë lavdin gjatë sukseseve dhe drejtoni gishtin tek dikush tjetër gjatë dështimeve atëherë ju nuk mund të jeni një lider i vërtetë.</p>
Motivimi	<p>Përveç që ju duhet të jeni vetë të motivuar gjatë gjithë kohës, ju duhet të keni shkathtësitë e duhura për t'i mbajtur të motivuar vazhdimisht ekipin për të arritur suksese. Motivimi bëhet në mënyra të ndryshme, si p.sh. duke iu dhënë përgjegjësi më të mëdha me kalimin e kohës apo duke i shpërblyer kur bëjnë një punë shumë të mirë. Është përgjegjësi e juaja të gjeni se çka funksionon tek ekipi juaj.</p>
Besueshmëri	<p>Anëtarët e ekipit tuaj duhet të ndihen rehat që të vijnë tek ju kur kanë ndonjë shqetësim, paqartësi, pyetje. Pra, të ndihen të lirë të bisedojnë çdo gjë me ju. Ju mund të jeni të besueshëm nëse edhe ju jeni të sigurtë dhe të hapur me ta.</p>

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Lidershipi, siç u tha, është veçanërisht i rëndësishëm në karrierën profesionale por kjo nuk do të thotë që ne këtë shkathtësi e përdorim vetëm atëherë. Madje është e rëndësishme t'i përdorim në moshë sa më të hershme në mënyrë që ta përsosim atë. Ne mund të tregojmë shkathtësi lidërsipit kur jemi kapiten/-e i/-e skuadrës sportive, kur jemi kryetar/-e i/-e klasës, kur e udhëheqim grupin gjatë punimit të një projekti grupor, kur gjatë aktiviteteve vullnetare e udhëheqim ekipin vullnetar apo projektin në përgjithësi, kur gjatë takimeve të ndryshme jemi ne ai apo ajo që e udhëheqim atë takim dhe rrjedhën e tij, etj.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojitet shkathtësia e lidërsipit

- » Menaxher/-e i/e projekteve
- » Oficer/-e i/e ushtrisë
- » Ndërmarrës/-e
- » Menaxher/-e i/e resurseve humane
- » Menaxher/-e i/e restoranteve
- » Specialist/-e i/e marrëdhënieve me publikun
- » Përfaqësues/-e i/e shitjesh
- » Politikan/-e
- » President/-e i/e shtetit
- » Kryeministër/-e i/e shtetit
- » Ministër/-e

2.8. Menaxhimi i kohës

Menaxhimi i kohës është proces me anë të të cilit ne i organizojmë punët dhe detyrat në mënyrë që ato të kryhen me kohë dhe të mos mbetemi mbrapa me planet tona. Secili person ka në dispozicion orët e njëjta për të bërë ato obligime që kemi, por arsyet pse disa ia dalin e disa jo në të shumtën e rasteve është sepse disa nga ta e menaxhojnë kohën më mirë se disa të tjerë. Kjo nuk do të thotë që duhet të punojmë më fort se të tjerët, por më shumë do të thotë që duhet të punojmë më mençur sesa të tjerët.

Pse janë të rëndësishme shkathtësitë e menaxhimit të kohës?

Shkathtësitë e menaxhimit të kohës janë të rëndësishme sepse ato na ndihmojnë edhe në aspekte të tjera të jetës. Nëse jemi të mirë në menaxhim të kohës do të thotë që ne mund të përfundojmë më shumë në një kornizë më të shkurtër kohore, kështu që do të kemi më pak presion rreth datave finale, do të kemi më shumë kohë të lirë (rrjedhimisht do të kemi një balancë shkollë-jetë) dhe do të jemi më pak të stresuar. Të gjitha këto janë përparësi të mëdha në jetë.

Shkathtësi të tjera që përfshihen në shkathtësitë e menaxhimit të kohës

Planifikimi	Planifikimi i ditës dhe detyrave që duhet përfunduar është një pikënisje e mirë për të menaxhuar kohën në përgjithësi.
Organizimi	Të jemi mirë të organizuar do të na ndihmojë t'i kemi gjërat nën kontroll. Për shembull, kalendari na ndihmon të dimë në çdo ditë çka kemi për të bërë (për shembull detyrat që kemi për të bërë apo lëndët në të cilat do të mësojmë) dhe mirëmbajtja e shënimeve në fletore, do të na e lehtësojnë menaxhimin e kohës.
Prioritizimi	Kur bëjmë planifikimin dhe organizimin e punëve ne duhet edhe t'i listojmë se cilat janë më me rëndësi sesa tjerat. Ky listim / prioritizim ndonjëherë edhe mund të duhet të ndryshohet përgjatë rrugës prandaj duhet të jemi të gatshëm për këtë.
Vendosja e qëllimeve	Kur dimë se çka kemi qëllim në fund atëherë ne e kemi më të lehtë edhe të planifikojmë, organizojmë dhe prioritojmë punët dhe do të kemi një ide më të qartë se si të ju qasemi atyre punëve.
Menaxhimi i stresit	Afatet e ngushta dhe puna voluminoze mund të sjellin stres, prandaj është e rëndësishme të arrijmë ta menaxhojmë stresin. Menaxhimi i stresit mund të arrihet duke bërë pushime të shkurtra. P.sh. pas çdo 25 minuta studim, mund të bëni 5 minuta pushim (teknika Pomodoro). Por kujdesuni të mos përdorni celularin gjatë këtyre minutave! Zgjatjet apo një ecje e shkurtër do t'iu ndihmonin më shumë! Për të menaxhuar stresin po ashtu mund të shpërbleni veten kur përfundoni ndonjë detyrë, për shembull të organizoni që në fundjavë të merreni me aktivitete që ju pëlqejnë dhe jo duke menduar për obligimet që keni ditën apo javën vijuese.

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla



Një shembull shumë i mirë se si një person e menaxhon kohën mirë është themeluesi i Microsoft, Bill Gates. Ai ka treguar që çdo ditë e tij është e mirë planifikuar dhe e ndarë në pjesë/detyra më të vogla për shkak të lehtësisë në menaxhimin e tyre. Po ashtu ai gjatë ditës sigurohet që gjithçka që bënë të jetë vetëm rreth punës dhe detyrave apo planeve që ai ka, më pas kur përfundon orarin e punës të ketë tërë kohën e mbetur të lirë për ta kaluar me familjen apo sido që ai dëshiron. Kështu ai bënë edhe një balancim të mirë punë-jetë që i mundëson po ashtu të pushoj dhe të rimarr energjinë e nevojshme për ditët në vijim.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojiten shkathtësitë e menaxhimit të kohës

- » Menaxher/-e i/e projekteve
- » Asistent/-e ekzekutiv/-e
- » Sekretar/-e
- » Inxhinier/-e softuerësh
- » Menaxher/-e i/e resurseve humane
- » Menaxher/-e i/e zyrës
- » Mjek/-e
- » Avokat/-e
- » Shofer/-e i/e transportimit të udhëtarëve

2.9. Negocimi

Procesi i negocimit përfshinë negocimin në mes dy apo më shumë palëve për të arritur një marrëveshje për temën apo problemin e diskutuar. Negocimi konsiderohet i suksesshëm atëherë kur secila palë e përfshirë në negocim ndahet e kënaqur me marrëveshjen e bërë. Ky lloj i marrëveshjes quhet “win-win” që do të thotë të gjitha palët përfitojnë. Kjo marrëveshje arrihet përmes kompromisit me njëri tjetrin. Asnjëra palë nuk do të ketë të gjitha që dëshiron por ato zakonisht ndahen të kënaqura nëse kërkesat kryesore arrihen të futen në marrëveshje, kështu secila sakrifikon diçka me qëllim që të arrihet një marrëveshje ku të gjitha ndahen të kënaqura.

Pse janë të rëndësishme shkathtësitë e negocimit?



Shkathtësitë e negocimit kanë një rëndësi më të veçantë në karrierën profesionale e veçanërisht në botën e biznesit. Nëse ne jemi negociator të mirë, kjo do të na ndihmojë që të arrijmë marrëveshje të kënaqshme për institucionin ku punojmë. Rrjedhimisht ajo marrëveshje do t'i sjell sukses dhe të ardhura institucionit ku punoni dhe kështu do ta mundësoni përparimin e institucionit. Të jesh në gjendje të bësh marrëveshje fitimprurëse për

të gjithë (win-win) do të thotë që të gjitha palët do të jenë të lumtura sepse interesi i secilës palë është marrë parasysh dhe duke u bazuar në këto interesa është bërë edhe formulimi i marrëveshjes.

Cilësitë që një negociator i mirë duhet t'i ketë

Një negociator i mirë ka këto cilësi:

- » Është një komunikues i mirë
- » Është i singertë
- » Është fleksibil
- » Është planifikues i mirë
- » Është i preokupuar që të gjitha palët të dalin fituese në marrëveshje

Shembull i përdorimit të shkathtësive të tilla

“Përvoja jonë na ka mësuar që me vullnet të mirë një zgjidhje e negociuar mund të gjendet edhe për problemet më të thella.”

- Nelson Mandela, ish president i Afrikës Jugore

Profesori i shkollës juridike në Harvard, Robert H. Mnookin, në librin e tij rreth negocimit, e liston Nelson Mandelën si një ndër negociatorët më të suksesshëm në histori. Ai flet për punën e Nelson Mandelës si një aktivist i lirisë dhe paqes në Afrikë, i cili në mënyrë paqësore luftoi kundër shtypjes racore që u bëhej njerëzve me ngjyrë posaçërisht në Afrikën e Jugut. Mnookin e cilëson lartë këmbënguljen, pragmatizmin dhe mendimin strategjik të Nelson Mandelës. Për më tepër, thotë se ai ishte i gatshëm të bënte lëshime por jo edhe për atë çka kishte më së shumti rëndësi për të e që ishin të drejtat e njerëzve me ngjyrë. Përkundër që ai hyri në burg shumë herë, madje një kohë ai edhe u dënua me burgim të përjetshëm, në fund ai arriti të shpallej i pafajshëm dhe pastaj u bë presidenti i parë me ngjyrë në Afrikën Jugore ku me këtë ngjarje historike ai edhe arriti të sigurojë të drejta për njerëzit me ngjyrë në Afrikën Jugore. Për ta cituar, Mnookin në librin e tij thotë: *“Ai përfundimisht arriti përmes negociatave një përfundim që kurrë nuk do të mund të arrihej vetëm përmes dhunës ose rezistencës.”*

Disa nga profesionet /pozitat ku nevojiten shkathtësitë e negocimit

- » Avokat/-e
- » Drejtor/-esh ekzekutiv/-e i/e kompanisë
- » Përfaqësues/-e shitjesh
- » Menaxher/-e i/e burimeve njerëzore
- » Menaxher/-e ndërtimi
- » Planifikues/-e i/e eventeve/-ngjarjeve
- » Agjent/-e i/e pasurive të paluajtshme
- » Psikolog/-e këshillimi
- » Ndërmjetësues/-e i/e negociatave

2.10. Shkathtësitë nderpersonale

Shkathtësitë nderpersonale janë ato shkathtësi të cilat e definojnë mënyrën se si ne bashkëpunojmë dhe komunikojmë me të tjerët.

Pse janë të rëndësishme shkathtësitë nderpersonale?

Shkathtësitë nderpersonale janë në top listën e shkathtësive më të rëndësishme për çdo fushë të jetës. Në cilëndo ueb faqe që hyni të lexoni për shkathtësitë e buta me shumë gjasa që do të gjeni pjesë të listës edhe këtë shkathtësi. Ajo madje shpeshherë përdoret si sinonim i shkathtësive të buta në përgjithësi. Ky fakt tregon për rëndësinë e madhe që kanë këto shkathtësi. Po ashtu kjo është një nga shkathtësitë tek e cila hyjnë edhe shumë shkathtësi të tjera që janë me shumë rëndësi edhe kur janë të veçuara. Kur i kemi të zhvilluara shkathtësitë nderpersonale e kemi më të lehtë të bashkëveprojmë me të tjerët dhe rrjedhimisht do ta kemi më të lehtë edhe të arrijmë deri tek suksesi.

Shkathtësi të tjera që përfshihen në shkathtësitë nderpersonale

Komunikimi	Gjatë bashkëveprimit me të tjerët, komunikimi me ta është i pashmangshëm. Pa marrë parasysh në çfarë pozita pune gjendemi neve do të na duhet të komunikojmë me kolegët tanë dhe për ta bërë këtë lehtësisht dhe në mënyrë efektive duhet të kemi shkathtësi të mira komunikimi.
Qëndrimi pozitiv	Për të pasur shkathtësi të mira nderpersonale ne duhet të kemi edhe qëndrim pozitiv ndaj çdo gjëje e veçanërisht ndaj personave me të cilët bashkëveprojmë.
Puna në ekip	Shkathtësia për të punuar në grup e po ashtu bashkëpunuar është një tregues i mirë që kemi shkathtësi të zhvilluara nderpersonale.
Lidershipi	Edhe gjatë kohës që ne jemi duke udhëhequr ndonjë grup do të na duhet të jemi në kontakt me një numër të konsiderueshëm personash, prandaj nëse kemi shkathtësi nderpersonale do ta kemi më të lehtë të tregojmë edhe shkathtësi lidershipi.

Rast i jetës së përditshme kur përdoren shkathtësitë nderpersonale



Zakonisht personat me shkathtësi të mira ndërpersonale janë ata persona të cilët lehtësisht dhe në një mënyrë shumë natyrale arrijnë të komunikojnë me të tjerët. Ata nuk e kanë aspak problem që të bashkëpunojnë me të tjerët për të arritur qëllime të përbashkëta dhe kanë gjithmonë një qëndrim pozitiv për jetën dhe situatat jetësore nëpër të cilat ata kalojnë. Ata në shumë raste janë kryesorët e grupit në shoqëri dhe pastaj në të ardhmen ata zgjedhin profesione në të cilat bashkëveprimi me të tjerët është shumë i shpeshtë.

Disa nga profesionet / pozitat ku nevojiten shkathtësitë nderpersonale

- » Infermier/-e
- » Arsimitar/-e apo profesor/-esh
- » Agjent/-e i/e shërbimit ndaj klientit
- » Shitës/-e në dyqane ushqimore apo të tekstilit
- » Asistent/-e administrativ/-e
- » Menaxher/-e marketingu
- » Moderator/-e i/e programeve televizive
- » Receptonist/-e
- » Kamerier/-e

Pyetje përsëritëse

- Cilat janë mënyrat e komunikimit?
- Përshkruaj një rast ku ju keni zgjidhur një problem dhe shpjego hapat e ndërmarrë.
- Trego rëndësinë e punës në grup.
- Tregoni një rast kur ju apo një i afërm i juaj ka përdorur shkathtësitë e menaxhimit të kohës.
- Çfarë cilësi ka një negociator i mirë? (Mund të përmendni edhe cilësi të cilat nuk janë përfshirë në modul).

Mbani mend

- Shkathtësitë e komunikimit janë shumë të rëndësishme për arsye se në masë të madhe përcaktojnë edhe mënyrën se si të tjerët na shohin ne dhe sa sukses do të kemi në jetë.
 - Përmes të menduarit kritik ne bëjmë zgjedhjet tona të cilat na përcaktojnë edhe të ardhmen tonë.
 - Shkathtësitë e lidhshimit kanë rëndësi të veçantë për ata të cilët në të ardhmen planifikojnë të jenë në pozita menaxhuese.
 - Shkathtësi të tjera që përfshihen në shkathtësitë e etikës së punës janë: profesionalizmi, produktiviteti, përkushtimi, disiplina dhe bashkëpunimi.
 - Shkathtësitë nderpersonale janë ato shkathtësi të cilat luajnë rol kyç në mënyrën se si ne komunikojmë dhe bashkëpunojmë me të tjerët.
-



3 Shkathtësitë e buta në jetë, shkollë dhe punë

3.1. Shkathtësitë e buta në jetë

Përderisa shkathtësitë e buta shpeshherë quhen edhe shkathtësi njerëzore (people skills) apo edhe shkathtësi ndërpersonale, ky është tregues i fuqishëm që ato janë shumë të rëndësishme në jetën tonë të përditshme. Nevoja për shoqëri dhe përkatësi janë thelbësore për njeriun, pa marrë parasysh se a pëlqejmë më shumë të qëndrojmë në vetmi apo në shoqëri të tjerëve, gjatë një dite, ne padyshim që do të na duhet të ndërveprojmë me të tjerët, qofshin ata familjarë, shoqëri, arsimitar/-e apo fqinjë. Përpos kësaj, secili nga ne ka nevojë të arrijë potencialin e vet, prandaj edhe angazhohemi në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore e sportive. Për shembull, gjatë një dite ne shkojmë në shkollë, kthehemi në shtëpi, qëndrojmë në kompjuter, disa nga ne mund të jenë të regjistruar në ndonjë kurs gjuhe, këndimi / instrumenti muzikor apo sporti, dalim me shoqëri apo me familje.

3.2. Shkathtësitë e buta në mjedis shkollë

Shkolla është vendi ideal ku fillon njoftimi dhe përvetësimi i shkathtësive të buta. Përvetësimi i këtyre shkathtësive ju ndihmon në adaptim më të lehtë në mjedisin shkollor, ju ndihmon të mësoni më shumë në kohë më të shkurtër, dhe të komunikoni në mënyrë efektive dhe të qartë me të tjerët. Shkathtësitë e buta mund të ndërthuren lehtësisht në aktivitete të përditshme mësimore dhe shoqërore.

Më poshtë mund t'i gjeni disa shkathtësi të buta dhe si mund të integrohen në aktivitete shkollore:

Komunikimi	Zhvillimi i shkathtësisë së komunikimit mund të arrihet duke prezantuar para klasës apo duke marrë pjesë në diskutime rreth mësimëve të shpjeguara në klasë.
Puna në grup	Kjo shkathtësi mund të zhvillohet duke caktuar nxënës me karakteristika të ndryshme të punojnë së bashku në projekte / detyra të përbashkëta duke vënë theksin në bashkëpunim, komunikim në mes vete dhe besim.
Ndershmëria / integriteti	Zhvillimi i kësaj shkathtësie mund të arrihet duke promovuar punën në grup. Secili anëtar i grupit mund të jetë përgjegjës për një punë specifike (për shembull, të hulumtoj rreth temës, të përgatisë prezantimin, apo të shpjegoj hyrjen e prezantimit). Kur të përfundohet kjo detyrë pastaj secili nxënës mund të reflektoj rreth kontributit të dhënë nga secili anëtar i grupit dhe notës grupore të marrë.

3.3. Shkathtësitë e buta në mjedis pune

Shkathtësitë e buta janë të rëndësishme për sukses në një vend pune. Ne edhe mund të pranoemi në një punë falë shkathtësive tona të forta / teknike, por për të qenë të suksesshëm në atë punë duhet të posedojmë shkathtësi të buta, të tilla si: komunikimi i mirë, puna ekipore, kreativiteti, mendimi kritik, fleksibiliteti, ndërgjeshmëria, etika e punës, shkathtësitë nderpersonale e të tjera. Në kohën e sotme shumë menaxherë të kompanive e organizatave të ndryshme i vlerësojnë shumë më shumë shkathtësitë e buta sesa ato të fortat, për arsye se shkathtësitë e forta janë më lehtë të mësueshme sesa ato të buta.

3.4. Rëndësia dhe demonstrimi i shkathtësive të buta

Rezultatet e një studimi të realizuar në vitin 2010 na treguan se vetëm 25% e suksesit në një punë afatgjate varet nga njohuritë teknike, ndërsa 75% e mbetur varet nga shkathtësitë e buta. Po ashtu në një pyetësor të kompanisë amerikane LinkedIn (2018) ku u përgjigjën 2,000 liderë biznesesh doli që 57% të këtyre liderëve vlerësojnë më shumë shkathtësitë e buta sesa ato të fortat.

Në ndërkohë edhe në kompaninë gjigante të Google, rezultatet e një projekti hulumtues që zgjati rreth 10 vite konfirmojnë të njëjtat gjetje. Projekti Oksigjen i filluar në vitin 2008, si qëllim përfundimtar kishte ta dinte se cilat cilësi e bëjnë një menaxher të mirë në Google. Sipas rezultateve, shumica e cilësive që e bëjnë një menaxher të mirë hyjnë në kategorinë e shkathtësive të buta. Këto përfshijnë: produktiviteti dhe orientimi nga rezultatet, trajner/-e i/e mirë, fuqizimi i ekipit, komunikimi i mirë, etj.

Kjo na lë të kuptojmë se nëse kemi dëshirë që në të ardhmen të fitojmë një vend pune e po ashtu të arrijmë ta mbajmë atë, ne duhet të kemi domosdoshmërishtë edhe shkathtësitë e buta krahas shkathtësive të fortat.

Më poshtë janë përmendur disa raste në të cilat ne demonstrojmë / përdorim shkathtësitë e buta:

- Kur jemi të përpiktë në orare, si për shembull, kur jemi në shkollë në kohë, ne përdorim shkathtësitë e menaxhimit të kohës dhe etikës.
- Kur ne punojmë në një projekt të përbashkët me shokët dhe shoqet e klasës ne përdorim shkathtësinë e punës në grup.
- Kur dalim të prezantojmë diçka para një audience (për shembull, para klasës) ne përdorim shkathtësitë tona të komunikimit.

Pyetje përsëritëse

- Pse na nevojiten shkathtësitë e buta në mjedise shkollore?
- Përmend një shkathtësi tjetër që nuk është përmendur më lart. Pastaj shpjego se si mund ta integrojmë në aktivitetet shkollore.
- Përmend disa arsye se pse shkathtësitë e buta kanë rëndësi?
- Cila është arsyeja që menaxherët e kompanive të ndryshme vlerësojnë më shumë shkathtësitë e buta sesa ato të forta, tek punëtorët e tyre?



Mbani mend

Shkathtësitë e buta janë të rëndësishme për disa arsye:

- Na ndihmojmë të bashkëveprojmë me të tjerët.
 - Na ndihmojnë që të komunikojmë qartë me të tjerët.
 - Na ndihmojnë të krijojmë shoqëri, gjë që është shumë e rëndësishme për mirëqenien tonë.
 - Na mundësojnë gjetjen dhe mbajtjen e një vendi të punës për një kohë të gjatë.
 - Na ndihmojnë që të përfundojmë detyrat (qofshin ato akademike apo profesionale) në mënyrën më të mirë të mundshme.
-

4 A janë të mësueshme shkathtësitë e buta?

Përderisa shkathtësitë e forta janë lehtësisht të mësueshme, e njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe për shkathtësitë e buta. Megjithatë shkathtësitë e buta mund të mësohen. Shkathtësitë e buta përderisa konsiderohen si pjesë e personalitetit tonë do të thotë se ato janë brenda nesh, por ne duhet të vetëdijesohemi për ekzistimin dhe përdorimin e tyre nga ana jonë. Më pas, mund të shfrytëzojmë situata të ndryshme ku ne mund t'i përdorim këto shkathtësi të buta, situata të cilat na shërbejnë për ushtrimin dhe përmirësimin e shkathtësive të buta.

Zhvillimi i shkathtësive të buta mund të bëhet në disa mënyra. Nuk ekziston ndonjë teknikë apo protokoll i caktuar për ta bërë këtë. Për t'i përmirësuar shkathtësitë e buta duhet të jemi më të motivuar dhe përkushtuar që t'ua përkushtojmë vëmendjen e duhur.

4.1. Si t'i përmirësojmë shkathtësitë e buta?

Pasi që të njohim se çka përfshihet tek shkathtësitë e buta, ne mund të identifikojmë se cilat nga to janë pikat e forta për ne dhe cilave prej tyre duhet t'iu kushtojmë më shumë vëmendje për t'i zotëruar më mirë.

Një mënyrë është përmes trajnimeve të ndryshme që ofrohen për shkathtësi të buta. Shumica nga ne jemi në rrjete sociale. Aty postohen njoftime të ndryshme, ku ofrohen trajnime për shkathtësi të buta. Këto trajnime ndonjëherë janë me pagesë por ka raste të shumta ku ofrohen pa pagesë për nxënësit dhe studentët e interesuar.

Një ide tjetër është që ta gjejmë një mentor/-e i/e cili/-a i ka shkathtësitë që ju dëshironi t'i zhvillonit më shumë, në këtë mënyrë mund t'i kthejmë këto shkathtësi në pika të forta të personalitetit tonë, të cilat do të na ndihmojnë jashtëzakonisht shumë në të ardhmen. Zakonisht kur jemi në moshë të re, mentorët që zgjedhim janë arsimtarët/profesorët me të cilët kalojmë një pjesë të madhe të javës tonë. Prandaj edhe është shumë e përshtatshme të zgjedhim një arsimtar i/e cili/-a mund të na ndihmojë të fitojmë shkathtësi të reja. Ju pasi që edhe jeni në kontakt të drejtpërdrejtë me ta, e keni edhe të lehtë t'i pyesni për gjithçka që ju intereson të dini. Kështu nga ta ju mund të mësoni shumë dhe në të njëjtën kohë t'i përmirësoni ato shkathtësi të cilat dëshironi t'i keni më të zhvilluara.

4.2. Vlerësimi i shkathtësive të buta

Ende nuk ka pyetësorë apo teste të cilat janë të standardizuara dhe përdoren në çfarëdo situatë për të vlerësuar nivelin tonë të shkathtësive të buta. Gjatë rekrutimit të stafit të ri, kompani të shumta interesohen nëse kandidatët i kanë shkathtësitë e nevojshme për atë vend pune. Vlerësimet që ata i përdorin varet nga nevojat e kompanisë dhe pozita e tyre e lirë e punës. Ata mund të përdorin teste të vlerësimit të personalitetit, pastaj në intervistë mund të bëjnë pyetje situative dhe në bazë të përgjigjeve të dhëna ata mund të vlerësojnë se sa e zhvilluar është ajo shkathtësi e caktuar. Disa shembuj të pyetjeve potenciale mund të jenë:

- » A mund të më tregoni një situatë në të cilën keni hasur në një problem dhe si e keni zgjidhur atë?
- » Në çfarë mënyre i priorizoni detyrat e juaja kur të gjitha e kanë afatin e fundit afër njëra-tjetrës?
- » Si ballafaqoheni në situata të reja?
- » Tregoni për një rast kur iu është dashur të punoni në një grup jo-bashkëpunuese dhe si keni vepruar?

Pyetje përsëritëse

- Përmend disa mënyra me anë të të cilave ne mund të përmirësojmë shkathtësitë tona të buta.
- Identifikoni një shkathtësi që keni nevojë ta zhvilloni dhe më pas tregoni se si planifikoni të arrini zhvillimin e saj.
- Mendoni për një person që do të donit ta kishit mentor dhe më pas tregoni pse mendoni që ai/ajo do të ishte personi i duhur të ju mbikëqyrë dhe udhëheq.

Mbani mend

- Me motivimin dhe përkushtimin e duhur shkathtësitë e buta mund të mësohen.
 - Njohja e llojeve të shkathtësive të buta na ndihmon në identifikimin e shkathtësive tona të buta që kanë nevojë për përmirësim.
 - Nuk ekzistojnë teste të standardizuara që ndihmojnë në vlerësimin e shkathtësive të buta por kompanitë mundohen të mësojnë rreth tyre nëpërmjet disa pyetjeve të cilat vijnë në dukje shkathtësi të ndryshme të kandidatëve.
-



5 Përmbledhje

Ky modul i shkathtësive të buta përbëhet nga katër kapituj. Kapitulli i parë ofron një pasqyrë rreth shkathtësive të buta dhe rëndësisë së tyre në jetën tonë. Më pas shpjegohen dy dallime shumë të rëndësishme të cilat shpeshherë janë konfuzë. Dallimi i parë që shpjegohet është në mes *aftësive* dhe *shkathtësive* të cilat përdoren shpesh si sinonime të njëra tjetrës por që në fakt kanë një dallim mjaft të madh. Një dallim tjetër që shpjegohet është edhe në mes *shkathtësive të buta* dhe *të forta*. Në bazë të shembujve të dhënë qartësohet dallimi në mes këtyre dy shkathtësive.

Kapitulli i dytë përfshinë pjesën kryesore të këtij moduli. Në këtë kapitull shpjegohen gjerësisht dhjetë shkathtësi të buta që janë shumë të njohura, e për të cilat nevoja për t'i pasur të zhvilluara është e lartë për arsye se ato na ndihmojnë në çdo aspekt të jetës. Shkathtësitë që shpjegohen në këtë kapitull janë: komunikimi, të menduarit kritik, shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve, puna në ekip, shkathtësitë e hulumtimit, etika e punës, lidhshipi, menaxhimi i kohës, negocimi dhe shkathtësitë nderpersonale. Përveç këtyre shkathtësive, ekzistojnë edhe shumë shkathtësi të tjera të cilat iu inkurajojmë që në kohën tuaj të lirë t'i eksploroni dhe të mësoni më shumë për to pasi që do të ju ndihmojnë shumë në të ardhmen tuaj.

Në kapitullin e tretë shpjegohet më gjerësisht rëndësia e shkathtësive të buta dhe përfshihen tri aspekte kryesore. Aspektet që u përfshihen janë: shkathtësitë e buta në jetë, në mjedis shkolle dhe në mjedis pune. Në secilën prej aspekteve përveç rëndësisë që kanë shkathtësitë e buta në atë aspekt, përmenden edhe shembuj apo raste ku përdoren shkathtësitë e buta në ato mjedise. Në fund të kapitullit përfshihen edhe disa hulumtime të cilat mbështesin rëndësinë e shkathtësive të buta dhe jepen shembuj se si mund t'i demonstrojmë shkathtësitë tona të buta.

Kapitulli i katërt dhe i fundit i këtij moduli thekson që përkundër stereotipit¹ që shkathtësitë e buta nuk mund të mësohen asnjëherë, në fakt me motivimin e duhur ato mund të mësohen apo të themi më mirë mund t'i përmirësojmë ato, pasi që shkathtësitë e buta konsiderohen si pjesë e personalitetit tonë pra ato veçse janë të integruara brenda nesh. Krejt çka duhet të bëjmë është të mësojmë rreth këtyre shkathtësive të buta dhe të identifikojmë se në cilat kemi nevojë të punojmë më shumë dhe pastaj t'i ushtrojmë e përmirësojmë ato. Në fund u shpjegohen edhe metodat që punëdhënësit përdorin për të vlerësuar shkathtësitë pasi që nuk ekziston ndonjë metodë/teknikë e cila mund të mat të gjitha shkathtësitë e buta.

¹ stereotipi është një besim i mbi-përgjithësuar për një gjë, person apo grup të caktuar.

Referencat

- ACT (2014). Cognitive and noncognitive skills. Retrieved July 7, 2020, from <http://www.act.org/content/dam/act/unsecured/documents/WK-Brief-KeyFacts-CognitiveandNoncognitiveSkills.pdf>
- Angeles, J., (2019). 3 Career Paths for People who Enjoy Teamwork. Retrieved July 17, 2020, from <https://www.upskilled.edu.au/skillstalk/career-paths-for-people-who-enjoy-teamwork>
- AppointmentPlus. (2015). What Is Time Management? Retrieved July 27, 2020, from <https://bit.ly/3gixXHS>
- Arkansas State University. (2016). 3 Main Types of Communication. Retrieved July 13, 2020, from <https://degree.astate.edu/articles/undergraduate-studies/3-main-types-of-communication.aspx>
- Beqiri, G., (2017). The Importance of Communication Skills in Business. Retrieved July 13, 2020, from <https://bit.ly/303XjT7>
- Bika, N. (n.d.). How to Assess Soft Skills in an Interview. Retrieved July 10, 2020, from <https://resources.workable.com/stories-and-insights/soft-skills-interview-questions>
- Brown, K. (2020). Hard Skills vs Soft Skills: The Value of Knowledge. Retrieved July 8, 2020, from <https://www.retrieve.com/hard-skills-vs-soft-skills/>
- Business Queensland. (n.d.). Negotiation skills. Retrieved July 30, 2020, from <https://www.business.qld.gov.au/running-business/marketing-sales/managing-relationships/negotiating/skills>
- Career Contessa. (n.d.). How to Assess Soft Skills in an Interview. Retrieved July 13, 2020, from <https://bit.ly/3fpTDRY>
- Clark, B., (n.d.). 10 Leadership Experience Examples for Interviews and Resumes Retrieved July 23, 2020, from <https://careersidekick.com/what-are-your-leadership-experiences/>
- Cleverism. (n.d.). Problem solving. Retrieved July 15, 2020, from <https://www.cleverism.com/skills-and-tools/problem-solving/>
- Cote, A., (2019). The Benefits of a Strong Work Ethic, and How It Can Help You Land and Keep Your Dream Job. Retrieved July 21, 2020, from <https://medium.com/paymo/the-benefits-of-a-strong-work-ethic-and-how-it-can-help-you-land-and-keep-your-dream-job-eb18201ad91>
- Dawson, G., (2018). Examples of Critical Thinking in Everyday Life. Retrieved July 14, 2020, from <https://blog.thinkcerca.com/critical-thinking-examples-everyday-life>
- Donnelly, G., (2019). 5 Great Examples of Time Management in the World. Retrieved July 28, 2020, from <https://blog.workep.com/5-great-examples-of-time-management-in-the-world>
- Doyle, A., (2019). Important Interpersonal Skills That Employers Value. Retrieved July 24, 2020, from <https://www.thebalancecareers.com/interpersonal-skills-list-2063724>
- Doyle, A., (2019). Important Leadership Skills for Workplace Success. Retrieved July 23, 2020, from <https://www.thebalancecareers.com/top-leadership-skills-2063782>
- Doyle, A., (2020). Critical Thinking Definition, Skills, and Examples. Retrieved July 14, 2020, from <https://www.thoughtco.com/critical-thinking-definition-with-examples-2063745>
- Doyle, A., (2020). Problem Solving Skills: Definition, Steps, and Examples. Retrieved July 15, 2020, from <https://www.thebalancecareers.com/problem-solving-skills-with-examples-2063764>
- Fort Hays State University. (n.d.). Careers in Leadership Studies. Retrieved July 23, 2020, from <https://www.fhsu.edu/leadership/careers/>

- Gerencer, T. (2020). Hard Skills vs Soft Skills: List of Best Examples for the Workplace. Retrieved July 9, 2020, from <https://zety.com/blog/hard-skills-soft-skills>
- Greene, J., (2016). Soft Skills: Preparing Kids for Life After School. Retrieved August 25, 2020, from <https://bit.ly/3grw8rD>
- Hackley, S., (2020). Best Negotiators in History: Nelson Mandela and His Negotiation Style. Retrieved August 6, 2020, from <https://www.pon.harvard.edu/daily/international-negotiation-daily/nelson-mandela-one-of-the-best-negotiators-in-history/>
- Harrell, M., & Barbato, L. (2018). Great Managers Still Matter: The Evolution of Google's Project Oxygen. Retrieved July 9, 2020, from <https://rework.withgoogle.com/blog/the-evolution-of-project-oxygen/>
- Henry, A., (2019). Productivity 101: An Introduction to The Pomodoro Technique. Retrieved August 25, 2020, from <https://lifelacker.com/productivity-101-a-primer-to-the-pomodoro-technique-1598992730>
- Herzing University. (n.d.). 7 Important Teamwork Skills You Need in School and Your Career. Retrieved July 17, 2020, from <https://www.herzing.edu/blog/7-important-teamwork-skills-you-need-school-and-your-career>
- Hetemaj, F. (2017). Can Soft Skills Be Taught? Retrieved July 8, 2020, from <https://bit.ly/32g2UZd>
- HKU Philosophy Department. (n.d.). Module: Critical Thinking. Retrieved July 14, 2020, from <https://philosophy.hku.hk/think/critical/ct.php>
- Indeed. (2020). 10 Soft Skills Interview Questions and Answers. Retrieved July 10, 2020, from <https://indeedhi.re/32ckVYz>
- Indeed. (2020). Critical Thinking Skills: Definitions and Examples. Retrieved July 14, 2020, from <https://www.indeed.com/career-advice/career-development/critical-thinking-skills>
- Indeed. (2020). Hard Skills vs. Soft Skills. Retrieved July 9, 2020, from <https://indeedhi.re/38RxxWn>
- Indeed. (2020). Problem-Solving Skills: Definitions and Examples. Retrieved July 15, 2020, from <https://www.indeed.com/career-advice/resumes-cover-letters/problem-solving-skills>
- Indeed. (2020). Research Skills: Definition and Examples. Retrieved July 20, 2020, from <https://www.indeed.com/career-advice/career-development/research-skills>
- Indeed. (2020). Time Management Skills: Definition and Examples. Retrieved July 28, 2020, from <https://www.indeed.com/career-advice/career-development/time-management-skills>
- Indeed. (2020). Work Ethic Skills: Top 8 Values to Develop. Retrieved July 21, 2020, from <https://indeedhi.re/2Bhig8P>
- Johnson, K. S., (n.d.). What Types of Jobs Are There for Research Oriented Personalities? Retrieved July 20, 2020, from <https://work.chron.com/types-jobs-there-research-oriented-personalities-11419.html>
- Lacombe, M., (2019). 5 Great Jobs for People Who Enjoy Teamwork. Retrieved July 17, 2020, from <https://www.libertystaffing.ca/blog/5-great-jobs-for-people-who-enjoy-teamwork>
- Lippman, L.H., Ryberg, R., Carney, R., Moore, K.A., & Trends, C. (2015). Workforce Connections. Key "Soft Skills" that Foster Youth Workforce Success: Toward a Consensus Across Fields. Retrieved July 7, 2020, from <https://www.childtrends.org/wpcontent/uploads/2015/06/2015-24WFCSoftSkills1.pdf>

Loudenback, T., (2016). The 20 best jobs for people who love to solve problems. Retrieved July 15, 2020, from <https://www.businessinsider.com/best-jobs-for-problem-solvers-2016-3>

Luenendonk, M., (2019). 7 Things You Should Do to Demonstrate A Strong Work Ethic to Your Employer. Retrieved July 21, 2020, from <https://www.cleverism.com/7-things-demonstrate-strong-work-ethic/>

Mckay, D. R., (2019). Critical Thinking. Why This Is an Essential Skill. Retrieved July 14, 2020, from <https://www.thebalancecareers.com/critical-thinking-525747>

Mind Tools. (n.d.). Essential Negotiation Skills. Retrieved July 30, 2020, from <https://www.mindtools.com/pages/article/essential-negotiation.htm>

Mind Tools. (n.d.). What Is Time Management? Retrieved July 27, 2020, from <https://www.thebalancecareers.com/interpersonal-skills-list-2063724>

Petrone, P. (2018). The Skills Companies Need Most in 2018 – And the Courses to Get Them. Retrieved July 9, 2020, from <https://learning.linkedin.com/blog/top-skills/the-skills-companies-need-most-in-2018--and-the-courses-to-get-t>

Resourceful Manager. (n.d.). 101 Inspiring Leadership Quotes. Retrieved July 23, 2020, from <https://www.resourcefulmanager.com/guides/101-inspiring-leadership-quotes/>

Resume.com. (2019). How to List Time Management Skills on a Resume | Best Skills and Examples. Retrieved July 28, 2020, from <https://www.resume.com/career-advice/resumes/time-management-skills/>

Robles, M. M. (2012). Executive Perceptions of the Top 10 Soft Skills Needed in Today's Workplace. *Business Communication Quarterly*, 75(4), 453–465. doi:10.1177/1080569912460400

Roux, M., (2017). Careers for People with Good Communication Skills. Retrieved July 13, 2020, from <https://www.oxbridgeacademy.edu.za/blog/careers-for-people-with-good-communication-skills/>

Smarp. (2019). Top 5 Communication Skills and How to Improve Them. Retrieved July 13, 2020, from <https://blog.smarp.com/top-5-communication-skills-and-how-to-improve-them>

Smith, J., (2020). 21 high-paying jobs for people who love to negotiate. Retrieved August 6, 2020, from <https://www.businessinsider.com/high-paying-jobs-for-people-who-love-to-negotiate-2016-3>

Strengthscape. (n.d.). Top 4 Reasons Why Negotiation Skills are Very Important in the Business World. Retrieved July 30, 2020, from <https://strengthscape.com/top-4-reasons-why-negotiation-skills-are-very-important-in-the-business-world/>

Study.com (2020). Careers Involving Research & Analysis. Retrieved July 20, 2020, from https://study.com/articles/careers_involving_research_analysis.html

Study.com (2020). Jobs That Require Negotiation Skills. Retrieved August 6, 2020, from https://study.com/articles/jobs_that_require_negotiation_skills.html

Terrell, S., (2019). What Are Interpersonal Skills and Why Are They So Important? Retrieved July 24, 2020, from <https://blog.mindvalley.com/what-are-interpersonal-skills/>

Tomaszewski, M., (2020). 30+ Time Management Skills & Examples for Your Resume. Retrieved July 28, 2020, from <https://zety.com/blog/time-management-skills>

TheBigChoice (n.d.). Research Skills. Retrieved July 20, 2020, from <https://www.thebigchoice.com/graduate-jobs/careers-advice/research-skills>

Thompson, V., (2017). Self-Esteem & Effective Communication Skills. Retrieved July 13, 2020, from <https://healthfully.com/187227-self-esteem-effective-communication-skills.html>

Vulkov, V., (n.d.). Strong Work Ethic Skills: Example Usage on Resumes, Skill Set & Top Keywords in 2020. Retrieved July 21, 2020, from <https://enhancv.com/resume-skills/strong-work-ethic/>

Wehbe, S., (2017). 5 Important Reasons Why Teamwork Matters. Retrieved July 17, 2020, from <https://bit.ly/3fGO9m7>

Wordhippo (n.d.). What is another word for soft skills? Retrieved July 7, 2020, from https://www.wordhippo.com/what-is/another-word-for/soft_skills.html